

VENDIM
Nr. 196, datë 22.9.2021

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT KRYESOR TË SHOQËRISË “ENERGY PLUS” SHPK, NËPËRMJET SHITJES SË 100% TË KUOTAVE TË SAJ

(ndryshuar me vendimin nr. 5, datë 13.1.2022)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.2, të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; pikës 5.2, të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.9.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 122/2 prot., datë 15.9.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. është mbajtëse e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 110, datë 22.12.2010, i ndryshuar, si dhe licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit nr. 109, datë 22.10.2010;

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 838 prot., datë 21.7.2021, shoqëria ka kërkuar nga ERE autorizimin për transferimin e kuotave që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, ndërsa me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 838/2 prot., datë 18.8.2021 dhe nr. 838/4 prot., datë 30.8.2021, shoqëria ka depozituar në ERE sqarime dhe dokumentacion shtesë;

- Kërkesa e shoqërisë vjen në zbatim të pikës 6.2, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” dhe të pikës 5.2, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”;

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 184, datë 10.9.2021, vendosi shtyrjen me 30 ditë të vendimarrjes për kërkesën e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të saj, nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave me 30 ditë, me qëllim vendosjen e komunikimit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe marrjen e informacionit përkatës për fazën në të cilën ndodhet dhënia e miratimit për këtë transferim nga MIE, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 838/5 prot., datë 10.9.2021, shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. ka depozituar një kopje të shkresës së MIE-s nr. 5792/2 prot., datë 7.9.2021, me anë të së cilës, MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka miratuar transferimin e pjesëve të kapitalit të shoqërisë koncesionare “Energy Plus” sh.p.k..

- Shoqëria ka paraqitur dokumentacion të nevojshëm për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut kryesor.

- Autorizimi nga ERE jepet (duke vlerësuar edhe miratimin/qëndrimin e Autoritetit Kontraktor), me kushtin që shoqëria “Energy Plus” sh.p.k., të ruajë emrin me të cilin është licencuar, si dhe të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në licencën për prodhimin e energjisë elektrike dhe licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me të cilat është pajisur.

- Në çdo rast, shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera për këtë transferim, nëse kjo kërkohet nga këto organe.

- Në zbatim të nenit 20, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në kuadër të dhënies së informacionit nga të licencuarit, shoqëria të njoftojë ERE-n pasi të bëhet efektiv ky transferim kuotash, sipas këtij autorizimi të dhënë nga ERE.

- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.
Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1 Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj.

2. Shfuqizuar.

3. Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera për këtë transferim, nëse kjo kërkohet nga këto organe.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti